



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:236288

Datë: 08.02.2024

Numri i dokumentit: 05300277

**C - IV. – 15 – 0623**

**Paditësi:**

I G nga fshati G i Komunës së Klinës.

**Kundër**

**E paditura:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lagjja, ”Lakrishtë”, Prishtinë.

**Për:** Palët.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjykatësin, Agron Hoxhaj, me **dt.07.02.2024**, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSIDEROHET e tërhequr** padia e paditësit, I G nga fshati G i Komunës së Klinës dhe atë për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore për padinë e ushtruar.

**II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

**Rrethanat procedurale dhe faktike**

Paditësi, me dt.25.04.2015, përmes postës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka paraqitur ankesë për rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PEJ172-0201, të dt.16.03.2015, të Ndërmarrjes Shoqërore (NSh) “KBI Malishgani”, me seli në Klinë (në likuidim) e me të cilin paditësi i është refuzuar kërkesa e tij për kompensimin e pagave të papaguara në vlerë të pa përcaktuar, dhe se paditësi e ka atakuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit për shkak të shkeljeve procedurale të dispozitave të organit të likuidimit, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe se paditësi ka kërkuar nga gjykata që ta miratojë kërkesën e tij si dhe ti njihet e drejta ligjore në kompensimin e 21 pagave të papaguara dhe të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit dhe se në ankesën e parashtruar e ka përcaktuar vlerën e tyre në shumën prej 3.150 €, si dhe periudhën nga dt.01.06.2002 e deri me dt.19.02.2004 e më gjerësisht si në këtë ankesë.

Paditësi e ka titulluar parashtrësën si “ankesë” mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi e duke u bazuar në nenin 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtrësave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pran Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesë apo ankesë.

Paditës, si prova, padisë së tij, ia ka bashkangjitur në kopje të tyre: vendimin e autoritetit të likuidimit PEJ172-0201, të dt.16.03.2015, regjistri e dt.12.08.2014 të punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore (NSh), “KBI Malishgani” me seli në Klinë, listën përfundimtare të punëtorëve, pranimin e ndërprerjes së marrëdhënies se punës si dhe padinë për kompensimin e të ardhurave personale të dt.19.02.2004.

Me Urdhrin e saj, C-IV.-15-0623, të dt.20.12.2022, gjykata ka urdhëruar të paditurën Agjencia Kosovare e Privatizimit që të parashtrojë përgjigje në padi.

Me dt.10.01.2023, e paditura, ka ushtruar përgjigje në padi, ku ka theksuar se i përmbahet qëndrimit se, Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht, e duke u bazuar në dispozitat e nenit 36.2.2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, e ka shtuar se ankesa e palës paditëse është e pa pranueshme dhe e pabazuar, me këtë i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj ankesën e paditësit dhe ta vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit e më gjerësisht si në këtë Mbrojtje.

Me dt.27.09.2023, kjo gjykatë me urdhrin e saj C-IV.-15-0623 të 27.09.2023, ka urdhëruar paditësin që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e tij në shumën prej 20.00 €, e duke e njoftuar se padia e tij, do të konsiderohet e tërhequr nëse brenda afatit të dhënë në këtë Urdhër, ai nuk e paguan taksën gjyqësore, për padi/ankesë dhe se pas tentimit të dorëzimit të urdhrin të dt.27.09.2023, ka konstatuar se pala ka ndërruar vendbanimin mirëpo deri më tani paditësi, nuk e ka njoftuar gjykatën për adresën e re të tij.

Me dt.06.11.2023, gjykata lejoji dorëzimin konstruktiv me publikimin në tabelën e shpalljeve të dokumenteve-shkresave të lëndës C-IV.-15-0623, ku e njëjta në tabelën e shpalljeve ka qëndruar nga dt.06.11.2023 deri me dt.21.11.2023 dhe se deri më tani pala paditëse, sërish nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e adresës së tij.

## **Arsyetimi ligjor**

Padia e paditësit, konsiderohet si e tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Ne bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë përshtatshmërisht - mutatis mutandis dispozitën përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa në nenin 253 par.5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), që ka të bëjë me mos pagesën e taksës gjyqësore për në një padi, parashihet se : *“Në qoftë së paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”*. Po ashtu në nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, parashihet se : *“Nëse taksa për padi, e përcaktuar sipas vlerës së kontestit në*

*padi, nuk paguhet deri në datën përfundimtare, edhe pas pranimit të vërejtjes për pagesën e saj, në rastet kur nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e palës nga detyrimi i pagesës, do të zbatohet neni 253 par.5 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ashtu që do të konstatohet se padia është tërhequr.’’.*

Me dt.27.09.2023, kjo gjykatë me Urdhrin e saj, C - IV.-15 – 0623 të dt.27.09.2023, e ka urdhëruar paditësin që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e tij në shumën prej 20.00 €, e duke e njoftuar se padia e tij, do të konsiderohet e tërhequr nëse brenda afatit të dhënë në këtë urdhër ai nuk e paguan taksën gjyqësore dhe se paditësi i është lejuar afati prej 15 ditësh, që t’u bëjë pagesën e taksës gjyqësore e sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor për të kryer pagesën e taksës gjyqësore për padinë e tij dhe se i njëjti, ka për obligim t’i paguaj taksat gjyqësore e të cilat aplikohen sipas nenit 6 të Udhëzimit Administrativ, nr.01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave gjyqësore. Duke qenë se paditësi, Urdhrin e kësaj gjykate, C - IV. - 15 – 0623 të dt.27.09.2023, që t’u paguaj taksës gjyqësore, nuk e ka pranuar sepse sipas postierit të postës lokale të dt.04.10.2023, pala ka ndërruar vendbanimin mirëpo paditësi deri më tani nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e adresës së tij dhe se për këtë arsye me dt.06.11.2023, lejoji dorëzimin konstruktiv të dokumenteve - shkresave të lëndës, C - IV. – 15 – 0623 e me publikimin në tabelën e shpalljeve për shkak se pala ka ndërruar vendbanimin, dhe gjykata nuk disponon me asnjë adresë tjetër të paditësit, ku i njëjti lajmërim në tabelën e shpalljeve ka qëndruar nga dt.06.11.2023 deri me dt.21.11.2023 dhe se me këtë konsiderohet se pala paditëse brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh por edhe as deri në kohën e vendosjes sipas këtij aktvendimi, nuk i është përgjigjur këtij Urdhri, për të bërë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e tij por as nuk ka provuar se në rastin e tij ekzistojnë kushtet ligjore për lirimin nga pagimi i taksës gjyqësore, si dhe se nuk e ka njoftuar gjykatën për adresën e re në mënyrë që gjykata të komunikonte me të si palë në procedurë, andaj edhe me arsyet e cekura më lartë, gjykata vendosi që padinë e paditësit, I G nga fshati G i Komunës së Klinës, t’u konsideroj si të tërhequr dhe atë për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenit 62 par.5 të Ligjit nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), gjykata vendosi që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 9, dhe 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe lidhur me nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ (UA) nr.01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave gjyqësore.

## **DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS** **2022:236288, 08.02.2024**

**Gjykatësi,**  
**Agron Hoxhaj**

### **KËSHILLË JURIDIKE :**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).